


KOMUNA SKENDERAJ ÒPSTINA SKENDERAJ Ndërmarrja Publike Lokale "Eko Natyra Sh.A. Skenderaj" NPL "Eko Natyra Sh.A. Skenderaj"			
Data: Prapori Gjizuar (Datum: Prapori Gjizuar) 31.10.2024			
Nomeni Org. Org. Jem	Sht.Klas. Klas. Koll	Nr. Prot. Br. Prot.	Nr. Protokol. Br. Protokol.
001	001	134/2024	009



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "EKO NATYRA" SH.A. SKENDERAJ

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E PARKINGUT NË POLIGONIN
MULTI FUNKSIONAL NË SKËNDERAJ.

SKENDERAJ
 2024

Bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-087, si dhe Plotësim Ndryshimi Nr.04/L-111 për Ndërmarrjet Publike, nenin 130 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare Nr.06/L-016, si dhe nenin 7.2 të Statutit të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko Natyra” Sh.A, Skënderaj, lidhur me punën në Parking, me qëllim të sigurimit të kushteve dhe funksionit të punës, Bordi i Drejtorëve në mledhjen e mbajtur me datë 25.10.2024, e miratoi këtë:

RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E PARKINGUT NË POLIGONIN MULTI FUNKSIONAL NË SKËNDERAJ.

KREU I DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i zonës të vendparkimeve, kushteve për shfrytëzimin e vendparkimeve, mënyrës së pagesës, çmimit dhe llojit të biletave për vendparkim, mënyrës së shfrytëzimit të tyre dhe mbikëqyrjes për parkimin e veturave në parkingun publik që është nën pronësinë e Komunës së Skënderajt.

Neni 2 Fusha e zbatimit

Kjo rregullore do të zbatohet ndaj të gjithë personave të cilët do të shfrytëzojnë hapësirën publike të parkimit e cila është nën pronësinë e Komunës së Skënderajt, e cila do të menaxhohet nga N.P.L “Eko Natyra” Sh. A në Skënderaj.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:

- 1.1 Parkim** - nënkupton çdo ndërprerje e lëvizjes së mjetit në rrugë në kohëzgjatje më shumë se tre minuta.
- 1.2 Parkingjet** - nënkupton hapësirën e dedikuar për parkimin e automjeteve, të cilat përbëhen nga një apo më shumë vende të parkimit.
- 1.3 Hapësira publike e parkimit** - nënkupton hapësirën e dedikuar për parkimin e Veturave, e cila është e rregulluar si vendparkim dhe e shënuar me shenja të komunikacionit dhe me informata rreth zonës së parkimit.
- 1.4 Automjetet** - nënkupton çdo mjet që lëviz në rrugë me fuqi të motorit të vet, i cili sipas konstruksionit, pajisjeve, veglave e pajimeve është paraparë për transport të personave.
- 1.5 Trotuar** - nënkupton sipërfaqja e rregulluar pranë rrugës posaçërisht për lëvizje të këmbësorëve, e cila nuk është në nivel me rrugën qarkulluese ose është e ndarë në mënyrë tjetër nga rruga.
- 1.6 Parkim me Laurë** – Nënkupton hapësirën e dedikuar për parkimin e automjeteve, në të cilën gjenden shumë vend-parkime dhe që është e vendosur rampa (Laura) me të cilën u lejohet hyrja në vendparkime shfrytëzuesve.
- 1.7 Parkim i përkohshëm** – nënkupton shfrytëzimin e vendparkimeve brenda dite.
- 1.8 Parkim mujor** – nënkupton shfrytëzimin e vendparkingjeve për një kohë të caktuar prej një (1) muaj.
- 1.9 Ndërmarrja** - nënkupton N.P.L “Eko Natyra” Sh.A.

Neni 4

Llojet e vendparkimeve publike

- 1. Vendparkimet publike janë disa lloje dhe për ndarjen e tyre merren për bazë disa kritere, e të cilat janë:**
 - 1.1** Sipas mënyrës shfrytëzimit të vendparkimeve publike;
 - 1.2** dhe në bazë të kohëzgjatjes së shfrytëzimit të vendparkimeve publike;
- 2. Ndarja e vendparkimeve publike në bazë të mënyrës së shfrytëzimit është si në vijim:**
 - 2.1** Vendparkim me Laurë;

3. Ndarja e vendparkimeve në bazë të kohëzgjatjes së shfrytëzimit të tyre është si në vijim:
- 3.1 Parkim i përkohshëm (deri 10 orë brenda ditës),
 - 3.2 Parkim mujor (prej 10 orë deri 24 orë shfrytëzim),
 - 3.3 Parkim mujor (me të drejtë shfrytëzimi prej orës 07:00 deri në ora 17:00 për personat të cilët janë në marrëdhënie pune)

Neni 5

Orari i punës

- 1. Orari i punës ndahet në sezonal dhe jo sezonal.
- 1.1 Orari i punës sezonal fillon nga data 1 Qershor deri me datë 1 Shtator, si dhe nga data 25 Dhjetor deri me datë 5 Janar, ndërrimi i parë duke filluar çdo ditë nga ora 07:00 deri 15:00, dhe ndërrimi i dytë nga ora 15:00 deri në ora 23:00.
- 1.2. Orari i punës jo sezonal fillon nga e hëna në të shtunën nga ora 10:00 deri në ora 18:00.

Neni 6

Kompensimi për shujtë

- 1. Punëtorët të cilët janë të caktuar të punojnë në Parkingun e Qytetit, për shkak të natyrës së punës që puna nuk mund të ndërpritet ata me marrëveshje gjatë kohës së pauzës qëndrojnë në vendin e punës, për këtë arsye bëhet kompensimi i shujtës ditore në shumë prej 2.5 Euro.

Neni 7

Kushtet e përgjithshme të parkingut

- 1. Ndërmarrja, nuk mbanë përgjegjësi për dëmtet që shkaktohen si pasojë nga vjedhja, shkatërrimi apo dëmtimi i automjetit të shfrytëzuesit në vendparkim, dhe nuk ka për obligim ruajtjen e automjeteve të parkuara që gjenden në menaxhimin e ndërmarrjes dhe as kompensimin e dëmeve eventuale.

2. Personat e regjistruar për shfrytëzimin e vendparkimit të ndërmarrjes pajisen me kartë të parkimit të caktuar për automjet e cila duhet të përmbajë afatin e vlefshmërisë dhe e cila vlen vetëm për adresën të cilën është regjistruar.
3. Regjistrimi nuk është i transferueshëm tek palët tjera.
4. Klientët obligohen që të paguajnë në hyrje shfrytëzimin e parkimit sipas çmimore.
5. Të gjitha automjetet që shfrytëzojnë parkingun e menaxhuar duhet të jenë me regjistrim valid dhe me polisë sigurimi. Automjetet që nuk posedojnë kushtet e qarkullimit rrugor nuk mund të parkohen në vendparkimin e menaxhuar nga Ndërmarrja.
6. Në rast të ndërrimit të targave/automjetit, klientët e regjistruar për shfrytëzimin e parkingut duhet ta njoftojnë personin e autorizuar dhe të regjistrohen përsëri në Ndërmarrje dhe po ashtu duhet të bashkangjitet kontrata.

Neni 8

Mënyra e kontrollimit të vendparkimit

1. Në vendparkim mund të bëhet kontrollimi i hyrjeve - daljeve të mjeteve motorike.
2. Kontrollimi nga par. 1 i këtij neni, mund të bëhet si në vijim:
 - 2.1 Obligohet punëtori i parkingut që me fillim të orarit të punës të bëjë evidentimin e të gjitha veturave të cilat gjenden në parking dhe ta bëjë regjistrimin e tyre në librin e punës.
 - 2.2 Duke vendosur laurën, pranë të cilës qëndron i punësuari i ndërmarrjes i cili pranon pagesën dhe e jep kuponin fiskal, në rast se kuponi fiskal nuk i jepet klientit atëherë përgjegjësinë do ta merr personi përgjegjës i Ndërmarrjes.
 - 2.3 Kontrollimin e biletës.
 - 2.4 Kontrollimin e mujores.
3. Kryeshefi Ekzekutiv me vendim e cakton Komisionin prej tre anëtarëve të cilët kontrollojnë mbarëvajtjen e punës në parking.
 - 3.1 Komisioni do të kryej kontrolla së paku një herë në javë.

Neni 9

Sinjalizimi i parkingjeve publike

1. Vendparkimet publike duhet të jenë të sinjalizuara me sinjalizim përkatës horizontal dhe vertikal, në përputhje me rregullat për siguri në trafik.
2. Vendparkimet përveç sinjalizimit për trafik, duhet të kenë të shënuar në vend të dukshëm të dhënat si: zonën e parkimit, çmimin e parkimit, kohëzgjatjen e parkimit, shenjat se vendparkimi është i rezervuar apo jo, destinimin e përdorimit të vendparkimit si dhe shenja tjera të nevojshme.
3. Të gjitha automjetet duhet të parkohen brenda hapsirës shenjëzuese (vijave të bardha të destinuara për parking).

Neni 10

Rregullimi, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi i vendparkingjeve

1. Ndërmarrja është e obliguar të rregullojë, mirëmbajë dhe të sinjalizojë vendparkimet publike,
 - 1.1. t'i vendos dhe ti mirëmbajë kamerat e sigurisë në Parking, me qëllim që të ofroj siguri për klientët.
2. Mjetet financiare për kryerjen e punëve nga par.1 i këtij neni, sigurohen nga të hyrat e inkasuara nga vendparkimet.

Neni 11
Tarifa e shfrytëzimit të vendparkimeve

1. Për shfrytëzimin e vendparkimit, shfrytëzuesit janë të obliguar të paguajnë çmimin e parkimit, varësisht nga koha e shfrytëzimit të vendparkimit
2. Me rastin e caktimit të tarifave nga ana e ndërmarrjes, duhet të merret parasysh mënyra e shfrytëzimit të vendparkimeve, kohëzgjatja e vendparkimit, mirëmbajtja e vendparkimeve dhe shpenzimet e tjera të nevojshme që ka ndërmarrja për ofrimin e këtij shërbimi.
3. Tarifat të cilat duhet të paguhen për shfrytëzim të parkingut janë të përcaktuara në shtojcën numër 1.

Neni 12
Kategoritë e liruara nga pagesa

1. Nga obligimi për pagesë për shfrytëzimin e vendparkimit lirohen kategoritë e cekura si në shtojcën 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 13
Mënyra e pagesës

1. Pagesa e parkimit do të kryhet tek inkasanti, si dhe forma tjera të cilat ndërmarrja me kalimin e kohës i sheh si më të arsyeshme për inkasimin e mjeteve.
2. Klienti është i obliguar ta ruaj kuponin fiskal me rastin e pagesës, kështu që në rast të kontrollit nga kontrollerët nëse rezulton se kuponi fiskal nuk ekziston, atëherë klienti detyrohet të paguaj shumën prej 5 euro për humbjen e kuponit fiskal.
3. Në rast se klientit nuk i jepet kuponi fiskal, i njëjti nuk është i detyruar të paguaj shërbimin.

Neni 14

Shkeljet brenda parkingut të menaxhuar nga NPL "Eko Natyra", Sh.A

1. Në rast të mos kryerjes së pagesës për parking, zyrtari (kontrollori) i Ndërmarrjes obligohet të pres 10 minuta nga momenti i parkimit të automjetit dhe nëse pas kalimit të këtij afati kohor qytetari nuk kryen pagesën, automjeti do të bllokohet përmes vendosjes së bllokadës. Vendosja e bllokadës bëhet nga zyrtari/kontrollori i Ndërmarrjes.
2. Në rastin nga par.1 i këtij neni, nëse shfrytëzuesi pas tetë (8) orë pritje nga koha e masës së ndëshkimit nga kontrollorët nuk ndodhët në vendngjarje ose kundërshton largimin e automjetit, zyrtarët (kontrollorët) e Ndërmarrjes, në bashkëpunim me zyrtarët e Policisë së Kosovës, do të urdhërojnë largimin e automjetit brenda afatit të caktuar.
3. Nëse personi të cilit i është bllokuar automjeti, paraqitet në vendparkimin e automjetit gjatë përgatitjes për bartje, do të obligohet të paguaj shumën prej 5 euro për ndërmarrjen, si dhe tarifat Policore.

Neni 15

Procedura për ankesa

1. Klientët në çdo kohë mund të ushtrojnë ankesë në Ndërmarrje, nëpërmjet:
 - 1.1 numrit të telefonit 048-906-345
 - 1.2 email adresës të Ndërmarrjes (eko.natyra2021@gmail.com)
 - 1.3 kutiat për ankesa të cilat gjenden në Parking.
2. Qytetarët të cilët ushtrojnë ankesa mbetën anonim.

Neni 16

Shtojcat


Shtojcat 1 dhe 2 i bashkangjiten kësaj Rregulloreje.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore u shqyrtua dhe u miratua në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të NPL “Eko Natyra” Sh.A, Skënderaj, të mbajtur me datë 25.10.2024 , dhe ka efekt veprimi nga data e aprovimit.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve



z.Albert Ismajli

SHTOJCA "1" ÇMIMORE PËR VENDPARKIM

Nr	EMERTIMI	ÇMIMI
1	PARKING DITOR DERI NË 10 ORË	1 EURO PËR ÇDO HYRJE
2	PARKING MUJOR I KUFIZUAR NGA ORA 07:00-17:00	15 EURO
3	PARKING MUJOR ME ORAR TË PLOTË	20 EURO

Vërejtje: shtojca "1" është e hartuar sipas organogramit të Ndërmarrjes.

SHTOJCA “2” KATEGORITË TË CILAT JANË TË LIRUARA NGA PAGESA:

1	AUTOMJETET ZYRTARE
2	TË GJITHË PUNËTORËT E NPL “Eko Natyra”, Sh.A, Skënderaj
3	AUTOMJETET DIPLOMATIKE
4	AUTOMJETET ZYRTARE TË SHËRBIMEVE EMERGJENTE (ME TARGA TË POLICISË, ZJARRËFIKËSIT DHE SHËRBIMET SHËNDETËSORE)
5	AUTOMJETET E FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS
6	TË GJITHË KRYETARËT E ORGANIZATAVE TË DALURA NGA LUFTA
7	PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA (TË CILËT POSEDOJNË SHENJËN PËRKATËSE NË AUTOMJET)